



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1256/2 Prot

Tiranë, më 11 / 8 / 2021

VENDIM

Nr. 38 , datë 11 . 8 . 2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1256 Prot., datë 22.07.2021, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet kërkesës datë 28.06.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Numrin aktual (viti 2021) të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë;
2. Raporti aktual mes numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar);
3. Numrin e gjyqtarëve në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Raporti i numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar), ndër vite;
4. Sa është aktualisht (viti 2021) dhe sa ka qenë në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 kohëzgjatja mesatare e një gjykimi për të gjitha gjykimet e parashikuara nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”,

*i ndryshuar dhe ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (çështje themeli, sigurim padie);*

- 5. Sa gjyqtar janë shkarkuar si pasojë e procesit kalimtar të rivlerësimit (Vetting-ut);*
- 6. Sa çështje gjyqësore i janë kaluar një gjyqtari tjetër, kur gjyqtari i ngarkuar i çështjes nuk ka mundur të kalojë procesin kalimtar të rivlerësimit (Vetting-un);*
- 7. Sa është nevoja për shtesë burimesh njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë;*
- 8. Sa është numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021;*
- 9. Sa është vlera e përlogaritur (vlera financiare) për rekrutimin e burimeve të nevojshme njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1256/1 prot., datë 23.07.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar lidhet me të dhëna të cilat krijohen në përmbushje të detyrave ligjore të Autoritetit Publik. Në këto kushte informacioni i kërkuar në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, "*informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*".

Për sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1256 Prot., datë 22.07.2021 të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 28.06.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (1. Numri aktual (viti 2021) i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; 2. Raporti aktual mes numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar); 3. Numri i gjyqtarëve në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Raporti i numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar), ndër vite; 4. Sa është aktualisht (viti 2021) dhe sa ka qenë në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 kohëzgjatja mesatare e një gjykimi për të gjitha gjykimet e parashikuara nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (çështje themeli, sigurim padie); 5. Sa gjyqtar janë shkarkuar si pasojë e procesit kalimtar të rivlerësimit (Vetting-ut); 6. Sa çështje gjyqësore i janë kaluar një gjyqtari tjetër, kur gjyqtari i ngarkuar i çështjes nuk ka mundur të kalojë procesin kalimtar të rivlerësimit (Vetting-un); 7. Sa është nevoja për shtesë burimesh njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; 8. Sa është numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021; 9. Sa është vlera e përlllogaritur (vlera financiare) për rekrutimin e burimeve të nevojshme njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë), brenda datës 18 . 8 .2021.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 11 . 8 .2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

